

Workshopi VII DEA SG2 të EUROSAT-t “Mbi projektin DEA dhe metodat e tjera të krahasimit”

Lisbonë, 5-6 dhjetor 2024

Në datat 5-6 dhjetor 2024, u zhvillua në Lisbonë, Portugali workshopi i VII mbi projektin DEA (Data Envelopment Analysis), i organizuar nga EUROSAT SG2, në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Norvegjisë. Ky aktivitet promovoi shkëmbimin e njohurive mbi përdorimin e metodës DEA dhe metodave të tjera të avancuara të krahasimit, të cilat synojnë përmirësimin e auditimeve të performancës.



Ditën e parë, aktiviteti nisi me prezantime mbi parimet themelore të DEA dhe aplikimet e saj. Prezantimet u përqëndruan në analizën e efikasitetit dhe produktivitetit, ndërsa pjesëmarrësit morën pjesë në diskutime dhe ushtrime praktike. Fokusi kryesor ishte në vlerësimin e efikasitetit në auditimet e performancës, duke përfshirë identifikimin e pyetjeve kyçe të

auditimit, metodat e mbledhjes së të dhënave dhe analizimit të tyre.

Ditën e dytë, u zhvilluan prezantime nga ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë mbi aplikimin e DEA-s në sektorin publik dhe kombinimin e saj me metoda të tjera të vlerësimit të efikasitetit. Pjesëmarrësit u angazhuan në raste konkrete studimore, duke përdorur aplikacionin pionier, i cili ndihmon në thellimin e aftësive praktike. Më pas pjesëmarrësit prezantuan dhe interpretuan rezultatet e tyre. Aktiviteti u përmbyll me diskutime mbi hapat e ardhshëm dhe fjalime përshëndetëse nga organizatorët.

Në këtë aktivitet, Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga znj. Aulona Jonuzi, Drejtore e Departamentit të Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional, dhe znj. Miranda Misini, audituese në këtë departament.